



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKES
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

05 NR. 294

Datë : 19.08.2025

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversital në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, :Ligjin për Arsim dhe aftësim profesional nr.04L-138 dhe Udhëzimin administrativ Nr.22/2013, numri maksimal i nxënësve në klasa dhe raporti mësimdhënës-nxënës si dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), të caktuara nga MASHT, Drejtoria komunale e Arsimit-Suharekë shpall

KONKURS PLOTËSUES
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe IAAP në vitin shkollor 2025/26, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2.Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- **Dëftesën** origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- **Ekstraktin e lindjes.**

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2025/2026, bëhet më datën 19, 20 dhe 21 gusht 2025, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 22.08.2025.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 23.08.2025.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimi të përgjigjes nga shkolla

A.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

Kushtet dhe kriteret e veqanta për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në gjimnaze dhe IAAP janë të detajuara në njoftimin e MASHT-it me nr 3/2497, i cili i është bashkangjitur konkursit.

SUHAREKË

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i nxën.
		Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Instalues elektrik	13
			Automekanik	4
			Metalpunues	24
			Mekatronikë	15
	Art		Rrobaqepsi	16
			Dizajn enterieri	15
			Dizaj i tekstilit dhe veshjeve	1
			Gjithsej: S. Luarasi	88
	"Abdyl Ramaj" Shirokë	Ekonomi, administim dhe juridik Shërbime (hoteleri-turizem)	Kontabilitet	4
			Banka dhe sigurime	1
			Asistent i mikëpritjes hoteliere/Mësim dual	12
			Teknologji e perpunimit te drurit (Mësim dual)	20
		Teknologji ushqimore	Teknologji ushqimore	10
		Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinar	Agrobiznes	13
			Gjithsej: A. Ramaj	60
	"Jeta e re"		Shkenca natyrore	22
			Shkenca shoqërore dhe gjuhësore	13
			Gjithsej: "Jeta e re"	35
			Gjithsej: Suharekë	183

Drejtorja e Arsimit-Suharekë
Remzi Bajselmani

